 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER SHKENCOR” NË GJUHË DHE LETËRSI TURKE E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-013-AL	01.10.2012	-	-	1 / 8

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Rregullores

Rregullorja e studimeve master shkencor në gjuhë dhe letërsi turke përcakton parimet e funksionimit të këtij programi.

Neni 2

Baza Ligjore

Rregullorja e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë të Shkollës së Lartë “ Hëna e plotë” (Bedër) mbështetet në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10307, datë 22.07.2010 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër), në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 03.04.2008 “Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë”, në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” si dhe në Statutin dhe Rregulloren Themelore të këtij institucioni.

KREU 2

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Neni 3


Objektivat formues specifikë të programit

Programi i Masterit Shkencor në Gjuhë dhe Letërsi Turke është një fushë e cila analizon Gjuhën dhe Letërsinë Turke. Ajo studion zhvillimin historik të gjuhës Turke, marrëdhëniet midis gjuhës dhe të menduarit, marrëdhëniet midis gjuhës dhe kulturës si dhe marrëdhëniet midis saj dhe letërsisë së shkruar. Programi përbëhet prej lëndëve të avancuara në letërsinë dhe kulturën Turke të ndërthurura me elementin gjuhësor si dhe nga lëndët kërkimore. Studentët zhvillojnë aftësi të shprehuri me shkrim, me gojë si dhe ato të të menduarit kritik nëpërmjet explorimit të letërsisë dhe gjuhës në kontekste të ndryshme kulturore dhe historike.

Gjuhë dhe Letërsi Turke është një fushë ndërdisiplinore e shkencës që studion gjuhën, letërsinë, folklorin, historinë, sociologjinë, dhe dokumentacionin.

Ky program synon të përfshijë të gjitha llojet e aspekteve praktike dhe teorike të fushës së studimit dhe synon të pajisë studentët me një sfond teorik për t'u bërë ekspertë në filologji dhe linguistikë.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER SHKENCOR” NË GJUHË DHE LETËRSI TURKE E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	2 / 8

Programi përgatit specialistë të aftë për të shkruar, vlerësuar, redaktuar dhe përkthyer letërsinë e shkruar në gjuhën turke si dhe do të përgatisë specialist të gjuhës dhe kultuës turke.

Studentët që do të mbarojnë programet e studimit master shkencor në gjuhë dhe letërsi turke do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh private apo publike që kanë marëdhënie me gjuhën dhe letërsinë angleze duke përfshirë redaktimin, përkthimin apo mësimdhënien në arsimin e lartë.

Neni 4

Organizimi i Studimeve

Studimet e ciklit të dytë Master i shkencave në gjuhë dhe letërsi turke zhvillohet në sistemin me kohë të plotë. Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor propozuar nga departamenti i Gjuhë dhe Letërsisë Turke dhe vendim i Këshillit të Administrimit të Fakultetit dhe miratur me vendim të senatit të shkollës së lartë.

Neni 5

Gjuha e Studimeve

Programit i studimit do të zhvillohet në gjuhën turke.

Neni 6

Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese

Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtarive të tjera formuese të programit është si më poshtë:

T - Orë Teorike

P - Orë Praktike

K - Kredite sipas Sistemit Amerikan

ECTS - Kredite sipas Sistemit ECTS

Programi master i shkencave në drejtësi me profil në të drejtën penale:

Semestri I								
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	TDE 401	Teknikat dhe metodat e kerkimit shkencor	Turqisht	A	64	86	3.5	6
2	TDE 411	Shqyrtimi I gjuhes turke	Turqisht	B	64	86	3.5	6
3	TDE 403	Shkenca gjuhesore (gjuhesi)	Turqisht	A	64	86	3.5	6
4	TDE 413	Burimet klasike te letersise turke	Turqisht	B	64	86	3.5	6
5		Lëndë me Zgjedhje	Turqisht	C	64	86	3.5	6
Gjithsej					320	430	17.5	30

Semestri II								
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	TDE 412	Gramatika e Turqishtes klasike Osmane	Turqisht	B	64	86	3.5	6

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

2	TDE 414	Burimi i veprave te Turqishtes se mesme	Turqisht	B	64	86	3.5	6
3	TDE 402	Transferimi i veprave te vjetra ne gjuhen aktuale	Turqisht	A	64	86	3.5	6
4	TDE 416	Burimet e reja te letersise turke	Turqisht	B	64	86	3.5	6
5		Lëndë me Zgjedhje	Turqisht	C	64	86	3.5	6
Gjithsej					240	510	17.5	30


Semestri III								
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	TDE 511	Kerkimet historike te gjuhes Turke	Turqisht	B	80	107.5	4	7.5
2	TDE 521	Ushtrime ne mesimdhenien e gjuhes se huaj dhe aftesite gjuhesore	Turqisht	B	80	107.5	4	7.5
3	TDE 551	Seminar	Turqisht	B	80	107.5	4	7.5
4		Lende me Zgjedhje	Turqisht	D	80	107.5	4	7.5
Gjithsej					320	430	16	30

Semestri IV								
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
	PSD 610	Tezë	Turqisht	F	320	430	10	30
Gjithsej					320	430	10	30

Lëndët me zgjedhje								
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	TDE 421	Menyrat dhe llojet letrare.	Turqisht	C	64	86	3.5	6
2	TDE 422	Kerkimet e letersise popullore	Turqisht	C	64	86	3.5	6
3	TDE 513	Metodat e mesimdhenies se gjuhes se huaj	Turqisht	D	80	107.5	4	7.5

Formim i përgjithshëm: 18 ECTS
 Formimi bazë: 52.5 ECTS
 Lëndët C: 12 ECTS
 Lëndët me zgjedhje: 7.5 ECTS
 Mikroteza: 30 ECTS

Njësia përpiluese Senati	Njësia kontrolluese Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Njësia miratuese Këshilli i lartë
-----------------------------	--	--------------------------------------

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER SHKENCOR” NË GJUHË DHE LETËRSI TURKE E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	4 / 8

Neni 7

Kurrikulat dhe objektivat formues specifikë të çdo veprimtarie formuese

Kurrikulat e ofruara studentëve gjatë programit si dhe objektivat formues specifikë të çdo veprimtarie formuese gjenden në tekstin bashkëngjitur.

Neni 8

Kreditet dhe detyrimet penguese për cdo disiplinë mësimore apo veprimtari tjetër formuese

Programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në Programin Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke:

Lëndët që do të marrin nga programi Bachelor:


- a. Pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:
- b. Me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	Gjuhë dhe Letërsi Turke	0 Kredite

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	1. Gjuhë Turke	0 Kredite
	2. Mësimdhënie në gjuhën turke	0 Kredite
	3. Mësimdhënie në gjuhën dhe letërsinë turke	0 Kredite
	4. Dialekte bashkëkohore turke	0 Kredite
	5. Gjuhësi	0 Kredite

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Departamenti i Shkencave të Komunikimit Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze Departamenti i shkencave të Edukimit	1. Gramatika E gjuhës turke 2. Osmanisht I 3. Teorite dhe njohuritë e letërsisë turke I 4. Gramatika e gjuhës turke II	5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë


 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER SHKENCOR” NË GJUHË DHE LETËRSI TURKE E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	5 / 8

		5. Gramatika e gjuhës turke III	5 ECTS
		6. Letërsia popullore turke II	5 ECTS
		7. Letërsia klasike turke II	5 ECTS
		8. Letërsia moderne turke I	5 ECTS
TOTALI		8 Lëndë	40 ECTS

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Gjuhë e huaj Letërsi	1. Gramatika e gjuhës turke E 2. Osmanisht I 3. Teorite dhe njohuritë e letërsisë turke I 4. Gramatika e gjuhës turke II 5. Gramatika e gjuhës turke III 6. Letërsia popullore turke II 7. Letërsia klasike turke II 8. Letërsia moderne turke I	5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS
	Totali	8 Lëndë	40 ECTS

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Shkenca Sociale Ekonomi Programe të ngjashme studimi	1. Gramatika E gjuhës turke 2. Osmanisht I 3. Teorite dhe njohuritë e letërsisë turke I 4. Gramatika e gjuhës turke II 5. Gramatika e gjuhës	5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS 5 ECTS

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER SHKENCOR” NË GJUHË DHE LETËRSI TURKE E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)			
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit
		01.10.2012	-	-

		turke III		
		6. Letërsia turke II	popullore	5 ECTS
		7. Letërsia turke II	klasike	5 ECTS
		8. Letërsia turke I	moderne	5 ECTS
	Totali	8 Lëndë		40 ECTS

Neni 9

Njohja e krediteve për njohuri të fituara më parë

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Komiteti Shkencor mund të njohë si kredite të formimeve universitare në Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë në Gjuhë dhe Letërsi Turke deri në 40 kredite të njohurive të veprimitarive formuese të fituara më parë nga studenti, të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit.

Neni 10

Forma e studimit, provimet dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët

Programi përbëhet nga 14 lëndë dhe teza e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Në një vit akademik realizohen të paktën 60 kredi ECTS.

Procesi mësimor përbëhet nga leksionet dhe seminarët të cilat jepen në mënyrë të integruar, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor.

Vlerësimi nga pikëpamja akademike për leksionet/seminarët, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse orë të zhvilluar në auditor. Vlera e krediteve të një lëndë përbëhet nga shuma e të gjithë orëve javore të leksioneve teorike javore dhe sa gjysma e orëve javore të aplikimeve, laboratoreve, projekteve dhe punës në atelje.


Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore; provimeve të fundvitit; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve. Me propozim të drejtuesit të programit përkatës dhe vendim të Komitetit Shkencor, studentit i jepet e drejta të hyjë në provim nëse nuk ka hyrë gjatë vitit për shkaqe të arsyeshme dhe të dokumentuara brenda tre ditëve.

Neni 11

Frekuentimi

Studenti në program ka detyrimin të ndjekë të paktën 70% të aktiviteteve mësimore kërkimore të zhvilluara në auditor të lëndëve teorike dhe të aktiviteteve mësimorë kërkimore. Studentët të cilët tejkalojnë këto norma duhet ta rimarrin përsëri atë lëndë me të gjitha detyrimet përkatëse.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER SHKENCOR” NË GJUHË DHE LETËRSI TURKE E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	7 / 8

Plotësimi apo jo i kushteve ne lidhje me pjesmarrjen, i paraqitet koordinatorit të programit nga ana e pedagogut të lëndës çdo muaj dhe kontrollohet nga Përgjegjësi i Departamentit.

Neni 12

Transferimi i studentëve

Kuotat për transferimet në Programin Master Shkencor në gjuhë dhe letërsi turke përcaktohen nga Komiteti Shkencor dhe miratohen nga Këshilli I Administrimit të Fakultetit, duke u bazuar në parimet e vendosura nga ky Këshill.

Studentëve të cilët janë transferuar në këtë program u jepet diplomë me kusht që të kenë kryer të paktën një semestër në Shkollën e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër).

Studentët që kanë kryer një semestër në një program të studimit të ciklit të dytë, mund të aplikojnë pranë Sekretarisë Mësimore brenda afateve të caktuara në kalendarin akademik, për t’u transferuar në Programin Master Shkencor në gjuhë dhe letërsi turke, në përputhje me parimet e vendosura nga ana e Senatit.

Kërkesa shqyrtohet nga Komiteti Shkencor i programit dhe Këshilli i Administrimit të Fakultetit merr vendim.

Neni 13

Numri i studentëve

Numri minimal i studentëve në Programin Master Shkencor në gjuhë dhe letërsi turke është gjashtë dhe ai maksimal është pesëdhjetë.


Për t’u pranuar në programin e studimeve Master i Shkencave në gjuhë dhe letërsi turke çdo shtetas shqiptar që aplikon nevojitet të ketë përfunduar studimet për një diplomë universitare të nivelit Bachelor me rezultate të mira. Preferohen ata studentë që kanë mbaruar ciklin e studimeve të nivelit Bachelor në Gjuhë dhe letërsi turke ose të ngjashme. Vlerësimi i titujve është kompetence e Departamentit të Gjuhë dhe Letërsisë Turke dhe bëhet me procedura publike. Synohet që me nivelin e lartë profesional të stafit që do të përfshihet në realizimin e këtij programi, të tërhiqen studentë të huaj për të kryer kërkime shkencore pranë këtij departamenti.

Neni 14

Udhëheqja e Tezës

Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore “Doktor. Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER SHKENCOR” NË GJUHË DHE LETËRSI TURKE E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	8 / 8

Neni 15

Niveli i Gjuhës Angleze

Studentët e programit të studimit në fjalë japin deri në diplomim provimin e gjuhës turke mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës turke është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës turke është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;

KREU 3 DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15 Zbatimi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj në Këshillin e Lartë të Shkollës së Lartë.

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Rektori.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë